



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1584 Prot.

Lezhë, më 02 . 02 . 2026

VENDIM

Nr. 6, Datë 28. 01. 2026

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, TË
CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË ASHK**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 64, ligjin nr.22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, ligjin nr.9321 datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave shtetërore dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", në VKM-në nr. 179, datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe në ligjin nr. 9321, date 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI :

1. Të përfundohen procedurat e privatizimit të apartamenteve për lidhjen e kontratave të shitblerjes para noterit, për banesat të cilat kanë mbetur pa u regjistruar pranë ASHK-së, sipas listës më poshtë:

Z. Dode Doda, Adresa; Banesa nr 149, Rruga-, Shkalla 1, Kati Përdhe, Lagjia Skëndërbeg, Lezhë

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij, për lidhjen e kontratës së privatizimit para noterit .

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

NDUE LULI

